

**AKT THEMELIMI DHE STATUT**  
**I**  
**SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

Ne Durres, sot ne date 23 Shtator 2019:

Erjon Kastrati ditelindja 24/06/1988, lindur ne Durres dhe banuese ne: Durres, shtetas shqiptar, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit me nr. Personal 180624072M

Me cilesine e ortakut te vetem ka redaktuar këtë akt themelimi dhe statut, per krijimin e shoqërise me pergjegjesi te kufizuar me emertimin “, në respektim te Kodit Civil, Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008,“Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare”, i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 “Per Qendrën Kombëtare te Regjistrimit”, i ndryshuar

**Neni 1**  
**Emertimi i Shoqerise**

- 1.1 Shoqeria e emertuar “Optimal Builder ”shpk (me poshte e quajtur “Shoqeria”),eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, themeluar ne perputhje me legjislacionin e Republikes se Shqiperise.
- 1.2 Shoqeria eshte themeluar sipas ligjit 9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, i ndryshuar dhe fiton personalitet juridik pas regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar Shqiptar prane Qendres Kombetare te Biznesit.

**Neni 2**  
**Selia**

- 2.1 Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen: Lagjja nr 17, Rrugë Dalip Peza, Objekt me nr pasurie 51979, Zona Kadastrale 8513, Durres
- 2.2 Shoqeria mund te hape zyra perfaqesimi, dege dhe/ose filiale dhe/ose te marre pjese ne shoqeri te tjera, te kryeje aktivitet ne vende te tjera, qofte brenda apo jashte territorit te Republikes se Shqiperise, ne perputhje me vendimet e Asamblese Pergjithshme te Ortakeve.

### **Neni 3 Kohezgjatja**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pacaktuar duke filluar nga data e regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

### **Neni 4 Objekti**

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të përfshijë, aktivitetet në fushën e ndërtimit, punime ndërtimi, import-export, tregëti të artikujve të ndryshëm etj...

Shoqëria, brenda caqeve të parashikuara nga legjislati në fuqi, do të kryejë çdo operacion tregtar e financiar që lidhet drejtëpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj.

### **Neni 5 Kapitali**

5.1 Kapitali i Shoqërisë është 100'000 Leke, i ndarë në 1 kuota, vlera e të cilave zotërohet nga Ortaket si më poshtë:

- **Erjon Kastrati**, mbajtes i 1 (një) kuota, e cila përfaqëson 100 % të kapitalit me vlerën 100'000 (nëqind mijë) leke;

5.2 Kuotat janë të transferueshme dhe mund të transferohen në çdo kohë në përputhje me kushtet dhe afatet që përcaktohen në ligjin shqiptar. Përgjegjësia e Ortakut shtrihet deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin e Shoqërisë.

### **Neni 6 Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve**

6.1 Në bazë të ligjeve dhe dispozitave të këtij Statuti, asambleja e përgjithshme e ortakeve të Shoqërisë është organi i vetëm vendimarrës i Shoqërisë. Ajo përfaqëson të gjithë ortaket dhe vendimet e saj, të marra në përputhje me ligjin dhe këtë Statut, janë detyruese për të gjithë ortaket, përfshirë ata që nuk marrin pjesë në votim dhe që votojnë kundër këtyre vendimeve.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve të mëposhtme:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të Shoqërisë;
- b) miratimi i ndryshimeve të statutit;
- c) emerimi e shkarkimi i anëtarëve të Këshillit Administrativ/Administratorit të Vetëm si dhe përcaktimi i kompetencave dhe shpërblimit të tyre;
- d) emerimi e shkarkimi i likuiduesve dhe ekspertëve kontabel të autorizuar si dhe përcaktimi i shpërblimit të tyre;

- e) mbikeqyrja e zbatimit të politikave tregtare nga Keshilli Administrativ/Administratori i Vetem, përfshirë mbikeqyrjen e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatëse;
- g) zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit të Shoqërisë pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatëse;
- h) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- i) caktimin e përfaqësuesit të Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj anëtarëve të Keshillit Administrativ/Administratorit të Vetem;
- j) miratimin e riorganizimit të Shoqërisë, përfshirë bashkimin me shoqëri të tjera, ndarjen e Shoqërisë, shndërrimin e Shoqërisë si dhe prishjen e Shoqërisë;
- k) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblese së ortakeve.
- l) çeshtje të tjera të parashikuara nga Ligji apo statuti.

Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e Asamblese duke patur të drejtën e votes në raport me vlerën nominale të kuotes së tij. Çdo ortak mund të përfaqësohet në vendimarrje nga një ortak tjetër, nga bashkeshorti(ja) ose nga çdo person tjetër, me kushtin që përfaqësuesit të jenë të pajisur me autorizimin për atë qëllim. Administratorët e shoqërisë nuk mund të jenë përfaqësues të ortakeve në mbledhjet e Asamblese së Ortakeve. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblese së ortakeve, por përfshin edhe mbledhjet me të njëjtin rend dite.

6.2 Administratori(et) sipas gjykimit të tij të lire ose me kërkesën e një dhe/ose me shumë ortakeve të cilët përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit të Shoqërisë dhe/ose eksperti kontabel i regjistruar nëse ka, dhe/ose likuiduesit kanë të drejtë të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme të Ortakeve. Në këto rast ortakeve duhet t'iu dërgohet një njoftim me shkrim për mbledhjen me postë elektronike (email) jo më vonë se 7 dite përpara datës së mbledhjes, i cili thekson qëllimin, vendin dhe orën e mbledhjes.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve thirret të paktën një herë në vit brenda 6 muajve nga përfundimi i vitit ushtrimor.

6.3 Përveç se kur parashikohet ndryshe nga Statuti, Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve vendos në mënyrë të vlefshme kur në mbledhje marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zoterojnë me shumë se 30% (tridhjetë përqind) të numrit total të votave dhe vendimet merren me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Për të vendosur shpërndarjen e fitimit, ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit të regjistruar si dhe riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve konsiderohet e mbledhur rregullisht kur janë të pranishëm ose të përfaqësuar ortakët që zoterojnë me shumë se 50% (pesëdhjetë përqind) të numrit total të votave. Vendimi merret me votën pro të të paktën 75% (shtatëdhjetë e pesë) përqind të ortakeve të pranishëm.

Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të vendosë për shkak të mungesës së kuorumit të përcaktuar më lart, ajo mbledhet perseri jo më vonë se 30 (tridhjetë) dite, me të njëjtin rend dite.

## Neni 7 Administrimi i Shoqerise

- 7.1 Administrimi i Shoqerise do te kryhet nga Administratori.
- 7.2 Administratori emerohet me vendim te Ortakeve dhe qendron ne kete detyre per nje afat jo me te gjate se 5 vjet. Administratori mund te rizgjidhet per te njeften periodhe me vendim te Ortakeve te shoqerise.
- 7.3 Administrator i Shoqerise do te jete:  
Erjon Kastrati ditelindja 24/06/1988, lindur ne Durres dhe banuese ne: Durres, shtetas shqiptar, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i leternjofimit me nr. Personal I80624072M
- Administratori mund te shkarkohen me vendim te ortakeve ne çdo moment per arsye te justifikuara.
- 7.4 Administratori eshte personalisht pergjegjes perpara Shoqerise dhe/ose paleve te treta per deme te shkaktuara nga shkelja e dispozitave te ketij Statuti ose te Ligjit.

## Neni 8 Detyrat dhe Kompetencat e Administratorit

- 8.1 Pasuria dhe aktiviteti tregtar i Shoqerise do te administrohen nga Administratori, i cili ka te drejte te ushtroje te gjitha kompetencat qe gjykon te nevojshme per realizimin e objektit te Shoqerise, me perjashtim te atyre qe ky statut dhe ligji i ka rezervuar Ortakeve te Shoqerise. Administratori mundte autorizojc apo emeroje me ane te prokures persona te trete per kryerjen e veprimtarive dhe/ose kompetencave qe i perkasin Administratoreve.
- 8.2 Kompetencat e Administratorit ne lidhje me administrimin dhe mbikeqyrjen e veprimtarise se Shoqerise percaktohen por pa u kufizuar, si me poshte vijon.
- (a) Te zbatoje politikat tregtare te Shoqerise dhe vendimet e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve;
  - (b) Te siguroje qe Shoqeria respekton ligjin(et) e zbatueshem dhe standardet kontabel;
  - (c) Te kryeje te gjitha veprimet ne lidhje me administrimin e veprimtarise tregtare te Shoqerise;
  - (d) Te perfaqesoje Shoqerine kundrejt paleve te treta, entiteve publike apo private, si dhe entiteve/ose autoriteteve vendase ose te huaja;
  - (e) Te pergatite dhe nenshkruaje pasqyrat financiare vjetore te Shoqerise te cilat do te miratohen nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve.
  - (f) Te kryeje te gjitha regjistrimet dhe publikimet e detyrueshme ne lidhje me Shoqerine sipas parashikimeve te ligjit te ne fuqi;
  - (g) T'i raportoje Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe kryerjen e veprimtarive tregtare qe mund te konsiderohen me rendesi te veçante per Shoqerine;

- (h) Te punesoje dhe te shkarkoje punonjes sipas politikave te shoqerise;
- (i) Te hartoje dhe te nenshkruaje deklaratat tatimore dhe cdo akt tjeter qe ka lidhje me dokumentacionin qe duhet te dorezohet prane Qendres Kombetare te Biznesit ose autoriteteve te tjera.
- (j) te kryeje detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne Statut.

### **Neni 9 Audituesit Ligjor**

Audituesi Ligjor do te emerohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve ne rastet kur kjoeshte kerkese elegjislacionit shqiptar. Riemerimi Audituesit Ligjor do te behet ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi. Audituesi Ligjor mund te shkarkohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve ne rast te shkeljeve te detyrave, gabimeve dhe sjelljes jo te mire profesionale.

### **Neni 10 Viti Ushtrimor**

Viti Ushtrimor fillon ne 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti. Perjashtimisht, viti i pare ushtrimor fillon me daten e regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe perfundon me date 31 Dhjetor 2019.

### **Neni 11 Shperndarja dhe Prishja**

- 11.1 Shoqeria mund te shperndahet me vendim te Asamblese se Pergjithshme. Shperndarja e shoqerise do te ndiqet nga prishja e saj.
- 11.2 Shoqeria do te ruaje personalitetin juridik, i cili do te sherbeje per qellimet e likuidimit dhe emrin e shoqerise do ta pasojne fjalet "ne proces likuidimi"
- 11.3 Likudatori(et) do te emerohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme. Prishja e Shoqerise dhe emerimi i likuidatorit(ve) do te kryhet ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

### **Neni 12 Ligji i Zbatueshem**

- 12.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete Statut dhe me ligjin shqiptar.
- 12.2 Per sa nuk eshte parashikuar ne kete statut, do te aplikohen dispozitat e ligjit shqiptar per shoqerite tregtare.

### **Neni 13 Mosmarreveshjet**

Per çdo mosmarreveshje qe mund te linde ne lidhje me zbatimin dhe interpretimin e ketij statuti dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde ndermjet Shoqerise dhe paleve te treta, kompetente per zgjidhjen e tyre do te jene gjykatat shqiptare.

**Neni 14**  
**Ndryshimet**

Ky statut mund te ndryshohet, rishikohet dhe/ose shfuqizohet pjeserisht ose teresisht dhe te zevendesohet me nje statut te ri me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Ky statut i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Optimal Builder" shpk hartohet ne 4 kopje ne gjuhen shqipe, me vlere te njejte secila.

**ORTAKET**

Erjon Kastrati

